

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, bazuar në nenin 16 të Ligjit nr.03/L-079, për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut, nr. 2006/50, për zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private duke përfshirë pronën Bujqësore dhe ate Komerciale, kolegji në përbërje prej gjyqtarëve, Ragip Namani kryetar i kolegjit, Beshir Islami dhe Nebojša Boričić anëtar, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Sherif Krasniqi, në çështjen juridike **të palës ankuese;**

J. Đ. V., Niš, R. e Serbisë

Kundër;

Palët përgjegjëse;

R. H., S. B., Xh. S., M. F., N.,G., Q.F., H. B., A. F., F. F., R. K. dhe N. M., të gjithë nga ...,

Duke vendosur lidhur me ankesën e paraqitur, kundër Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës, KPPC/D/A/156/2012, të datës 06 Qershor 2012, (lënda e regjistruar në AKP me numër **KPA92402**), pas shqyrtimit të mbajtur me datë, 12 Maj 2020, merr;

AKTGJYKIM

Hedhet Poshtë si e pas afatshme, Ankesa e paraqitur nga J. Đ. V., kundër Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës, KPCC/D/A/156/2012, të datës 06 Qershor 2012, për sa i përket kërkesës të regjistruar në AKP, me numër KPA92402.

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike;

1. Me datë 05 Shtator 2006, V. J., (në tekstin e mëtejme: pala ankuese), ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (në tekstin e mëtejme: AKP), në cilësinë e bartësit të drejtës pronësore, me të cilën kërkon fillimisht ri-posedimin e ngastrës kadastrale, nr. ..., me sipërfaqe prej 1.97.40 ha, me kulturë tokë bujqësore, e cila gjendet në vendin e quajtur, "...", Komuna Kadastrale ..., Komuna Prishtinë,(tutje prona e kërkuar).
2. Si datë të humbjes së posedimit të pronës në kërkesë e shënon datën 14 Qershor 1999, ndërsa thekson se në muajin shtator 1999, është zhvendosur në Serbi-Nis, për shkak të rrethanave të vitit 1999. Thekson se prona e kërkuar,(sipërfaqja rreth 40 ari), aktualisht është e uzurpuar nga palët përgjegjëse në mënyrë të kundërligjshme, prandaj kërkon kthimin e posedimit, ose pagesën e vlerës së trullit në shumën prej 900.000,00, €.
3. Së bashku me kërkesën në AKP, pala ankuese ka dorëzuar *inter alia*:
 - Letërnjoftimin me nr. pers. 1170529703, në emër të tij, lëshuar me datë 19.09.2005.

- Vendimin e Trashëgimisë, T. Nr.102/05, të dt. 07/04/2005, lëshuar nga Gjykata Komunale në Prishtinë, sipas të cilit pala ankuese e ka trashëguar pronën e kërkuar ,ngastrën kad. nr. ..., në sipërfaqe prej 1.97.40ha., nga nëna e tij e ndjerë L. J.
 - Kopjen e planit nr. ..., të dt. 18.05.2005, lëshuar nga departamenti i kadastrit paralel, sipas së cilës ngastra e kërkuar është e regjistruar në emër të nënës së palës ankuese L. J.
 - Kopjen e Planit sipas Fl. Posed. ..., nr. i planit ..., të dt. 13.04.2006, sipas së cilës prona e kërkuar ngastra kadastrale numër ..., evidentohet në emër të palës ankuese.
 - Certifikatën nga libri amë i të lindurve në emër të palës ankuese me nr. rendor ..., të dt. 27.02.1998.
 - Certifikata mbi të drejtat e pronës së pa luajtshme,(tutje; CDP), nr. UL---..., të dt. 06.07.2005, sipas së cilës vërtetohet se prona e kërkuar evidentohet në emër të palës ankuese.
4. Njoffimi i kërkesës së palës ankuese nga ekipi i AKP-së, ishte bërë për herë të parë më 15 tetor 2007, ashtu si e kishte theksuar në kërkesën e tij për ngastrën ..., e cila sollti rezultat në qasjen e palës përgjegjëse S. B. për këtë ngastër, i cili kishte ofruar dokumente për ngastrën kad. ..., por që kjo nuk kishte të bënte me pronën e kërkuar. Sipas dëshmime materiale të paraqitura nga pala ankuese përmendet vetëm ngastra kadastrale nr. ...
 5. Me 12 korrik 2011, ishte bërë notifikimi për ngastrën lëndore .., ku edhe pala ankuese është pajtuar dhe ka konfirmuar se e ndryshon kërkesën fillestare, tani kërkesa e tij ka të bëjë pikërisht për ngastrën kadastrale numër ..., për të cilën kishte ofruar dëshmitë e paraqitura.
 6. Gjatë këtij notifikimit ishte dëshmuar se në pronën e kërkuar ngastrën ..., ishin ndërtuar shtëpi të reja të palëve të treta, -palëve përgjegjëse (tutje PP), si në vijim; R. H., S. B., Xh.. S., M. F., N. G., Q.l F., H. B., A. F., F. F., R. K. dhe N. M., të gjithë nga ..., të cilët kishin pretenduar të drejtë ligjore mbi pronën e kërkuar dhe kishin nënshkruar formularin e pjesëmarrjes në procedurë.
 7. Gjatë përpunimit të kërkesës së palës ankuese sekretaria kishte gjetur se disa pjesë të pronës së kërkuar nga pala ankuese më herët ishin shitur. Kjo ishte konfirmuar edhe nga vet ai i cili po ashtu kishte theksuar se nuk ishte në pajtim me çmimin shitës, por ai nuk kishte pretenduar se shitjen e ka bërë nën presion apo kërcënim.
 8. **Kërkesa fillestare e paraqitur në AKP, me numër KPA00059**, nga sekretaria e AKP-së, ishte ndarë duke u krijuar edhe tetë kërkesa të reja, sipas bazës se gjatë vizitës së pronës së kërkuar, e njëjta është gjet e ndarë në 12 pjesë, -parcela fizikisht të ndara, andaj edhe kishte mbi tri kërkesa të palëve përgjegjëse (mbrojtëse). Me këtë ndarje nuk ishte cenuar asnjë e drejtë e palës ankuese lidhur me pronën e kërkuar. Gjithashtu sekretaria kishte vlerësuar se në rast të një ankese të mundshme nga palët përgjegjëse nuk do të cenoheshin të drejtat individuale të secilës palë përgjegjëse nëse ndonjëri nga ata do të kundërshtonte vendimet e veçanta të KKPK-së sipas kërkesave të ndara. Nga kërkesa fillestare ishin formuar kërkesat e reja për pronën e njëjtë, ngastrën kadastrale, nr. ..., dhe ishin formuar lëndët si në vijim; KPA92402, KPA92403, KPA92404, KPA92405, KPA92406, KPA92407, KPA92408, dhe KPA 92409.

9. Pala ankuese me njoftimin e dt. 20.02.2012, ishte njoftuar për ndarjen e kërkesës fillestare dhe formimin e kërkesave të reja si më lartë, dhe i ishte sqaruar se ndarja e kërkesës fillestare dhe formimi i kërkesave të cekura nuk e cenon në asnjë mënyrë të drejtën e tij për pronën e kërkuar.
10. Për kërkesën e ndarë lëndore KPA 92402, gjatë kohës së vizitës së ekipit të AKP-së, me dt. 12.korrik 2011, pala përgjegjëse M. F., me banim në ... ishte gjendur duke e shfrytëzuar një pjesë të pronës së kërkuar, në të cilën kishte ndërtuar shtëpi të re, ai ishte prezent dhe e kishte nënshkruar formularin e pjesëmarrjes në procedurë duke pretenduar të drejtë ligjore në pronën e kërkuar me pretendim si edhe palët tjera përgjegjëse se e ka blerë pronën- pjesën në të cilën ka ndërtuar shtëpinë.
11. Palët përgjegjëse të tjerë, disa prej tyre si N. F., A.F., R. K., N. M., dhe Q. F., kishin autorizuar avokat Xh. K. nga ... që ti përfaqësoj tutje në procedurë në APK, avokati kishte pohuar se pala ankuese ua kishte shitur pronat klientëve të tij, por ai tani nuk është i kënaqur me çmimin e atëhershëm të shitblerjes. Palët përgjegjëse po ashtu kishin konfirmuar se një pjesë e pronës së kërkuar nuk u ishte shitur, ata kishin menduar se është tokë e braktisur -utrinë ku edhe kishin ndërtuar shtëpitë e tyre në mirëbesim, por tani me që është prona në emër të palës ankuese, pranojnë që me te të arrijnë marrëveshje për kompensimin -pagesën e tokës ku kanë ndërtuar shtëpitë.
12. Në mbështetje të përgjegjës së tyre palët përgjegjëse në AKP dhe për mes përfaqësuesit të tyre avokat Xh. K., kanë paraqitur në mes tjerash dokumentet si në vijim të verifikuara edhe nga AKP-ja pozitivisht;
 - Padinë e ushtruar në Gjykatën Komonale në Prishtinë C.nr.239/05, të dt. 28.02.2005,të ushtruar nga pala ankuese V. J., kundër të paditurve,(palëve përgjegjëse N. F. dhe të tjerëve për ri posedimin e pronës së tij të uzurpuar nga palët përgjegjëse.
 - Kundër padinë e ushtruar nga palët përgjegjëse në Gjykatë Komonale Prishtinë, C. Nr. 2959/10, të dt. 28.12.2010, për mes të autorizuarit të tyre av. Xh. K., kundër palës ankuese V.J., për konfirmimin e të drejtës pronësore në pronën lëndore.
13. Pala ankuese V. J. në AKP, kishte pohuar se ai në vitin 2005 kishte ushtruar padi, në Gjykatë Komonale në Prishtinë kundër të paditurve (disa prej palëve përgjegjëse), me të cilën kishte kërkuar ri posedimin e pronës së tij. I njëjti kishte konfirmuar se akoma gjykata nuk kishte vendosur me vendim meritor sipas padisë së tij, prandaj kishte shprehur më shumë interesim që AKP-ja të zgjidh çështjen e ngritur me kërkesën e tij, lidhur me pronën lëndore.
14. Sipas raportit të konsoliduar të verifikimit të datës 17 maj 2012, dokumentet e paraqitura pronësore nga pala ankuese ishin verifikuar pozitivisht, njëjtë edhe sipas Certifikatës Pronësore (CDP), P-..., të dt. 27.04.2011, të siguruar *ex officio*, pala ankuese V. J., paraqitet pronar me 1/1, pjesë ideale, i ngastrës kad. nr. ..., sipas vendimit të trashëgimisë të vitit 2005.
15. Me 06 Qershor 2012, Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KKPK), përmes vendimit të vet KPCC/D/A/156/2012, (në tekstin e mëtejme: Vendimi i

KKPK-së), dhe vendimit individual i ka hedhur poshtë kërkesat e palës ankuese KPA00059, **92402**, 92403, 92404, 92405, 92406, 92407, 92408 dhe 92409, lidhur me pronën e kërkuar, ngastrën **kad. nr. ..., me sipërfaqe prej 1.97.40ha**, e cila gjendet në vendin ..., e cila evidentohet në Fletën Poseduese nr. Ul-... . Në arsyetim të vendimit grupor,(paragrafi 11, 85, 86 dhe 87),që aplikohet në mënyrë specifike për kërkesën konkrete, KKPK-ja ndër të tjera ka theksuar se, nga vendimi i trashëgimisë T nr. 102/2005, dt. 07 Prill 2005, paraqitësi i kërkesës e ka dëshmuar se ai e ka trashëguar pronën lëndore nga nëna e tij, ndërsa edhe nga sekretaria *ex officio* është konfirmuar kjo sipas certifikatës pronësore të azhuruar, se ai është pronar. Paraqitësi i kërkesë kishte njoftuar AKP-në se ai kishte ushtruar padinë kundër palëve përgjegjëse me nr. C. Nr. 239/05, dt. 28 shkurt 2005 në Gjykatën Komunale Prishtinë, për ri posedimin e pronës. Në anën tjetër palët përgjegjëse pretendojnë se kanë bërë pjesë të pronës lëndor andaj për këtë kanë ushtruar padi kundër palës kërkuese në vitin 2010 në Gjykatë Komunale Prishtinë dhe lënda është në pritje për tu gjykuar. Andaj KKPK gjen se në kuptim të nenit 18 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 (në tekstin e mëtejme: Ligji nr. 03/L-079), përjashtohet juridiksioni i Komisionit sepse procedurat gjyqësore lidhur me kërkesat kanë filluar para datës 16 tetor 2006, datë kjo kur ka hyrë në fuqi Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar me Ligji nr. 03/L-079. Andaj pasi procedimi gjyqësor në lidhje me pronën e kërkuar nga pala ankuese kishte filluar në vitin 2005 në gjykatë të rregullt, kërkesat nuk janë nën juridiksionin e komisionit dhe duhet të hedhen poshtë.

16. Vendimi i KKPK-së për kërkesën KPA92402, objekt i kësaj lënde i është dorëzuar palës ankuese V. J., me datë **20 Mars 2013**, ndërsa palës përgjegjëse, M. F. me dt.20.03.2013, dhe me datë 04.06.2013.
17. Me datë 27 Prill 2016, pasi që vendimi i komisionit nuk ishte ankimuar nga asnjë palë në afatin e paraparë ligjor, lënda në AKP ishte mbyllur,(shih akti faqe 003, në shkresat e lëndës).
18. Me datë **09 Dhjetor 2016**, pala ankuese V. J., ka paraqitur ankesë kundër vendimit të KKPK-së.
19. Me datë 08 Shkurt 2017, kopja e ankesës së palës ankuese, e cila kishte të bënte me të gjitha kërkesat e cekura, i ishte dorëzuar palëve përgjegjëse dhe atë; S. B., M. F., Q. F., A. F.. Me datë 14 Mars 2017, palëve përgjegjëse N. G., H. B., F. F., ndërsa me datë 13 shkurt 2017, palëve përgjegjëse, R. K., R. H., N. M., Xh. S., megjithatë asnjëri prej tyre nuk provohet se kanë paraqitur përgjigje në ankesën e palës ankuese.

Pretendimet e palës ankuese;

20. Pala ankuese në ankesë thekson se, Vendimi i KKPK-së është jo ligjor dhe jo i drejtë, me të cilin është hedhë kërkesa e tij për kthimin e pronës së tij e cila është e uzurpuar pa të drejtë nga uzurpuesit e njohur të cilët në pronën e tij kanë ndërtuar shtëpi në të cilat jetojnë, se në AKP i ka ofruar të gjitha dokumentet valide që e dëshmojnë pronësinë e tij në këtë pronë ngastrën kad ..., se uzurpuesit pjesët e pronës së tij i kanë uzurpuar menjëherë pas konfliktit të viteve 1998/99, tutje e përshkruan dhe e citon sipas vlerësimit të tij vendimin e ankimuar, ndërsa në fund kërkon

që ankesa e tij të aprovohet vendimi i ankimuar të anulohet, ashtu që gjykata supreme edhe një here ta rishqyrtoj çështjen, të vendos në mënyrë të drejtë dhe t'ia kthej në pronësi dhe posedim pronën- ngastrën kadastrale nr. ..., sepse është e tij.

Arsyetimi ligjor;

Pranueshmëria e ankesës,

21. Ankesa është e pa pranueshme, sepse është e pas afatshme për sa i përket Vendimit KPCC/D/A/156/2012 , të dates, 06 Qershor 2012.
22. Neni 12.1, i Ligjit nr. 03/L-079, Mbi zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale (në tekstin e mëtejme “Ligji nr. 03/L-079”) përcakton si në vijim: *“Brenda tridhjetë (30) ditëve nga njoftimi i palëve nga Agjencia Kosovare e Pronës për vendimin e Komisionit mbi ankesën, pala mund të paraqes ankesë ndaj vendimit të tillë në Gjykatën Supreme përmes Sekretarisë Ekzekutive të Agjencisë Kosovare të Pronës”*.
23. Pala ankuese e ka pranuar personalisht Vendimin e KKPK-së , nr. KKPC/A/156/2012, të dt. 06.06.2012, për lëndën kpa 92402, **me datë 20 Mars 2013**, që konfirmohet me nënshkrimin e tij. Megjithatë ankesën kundër këtij vendimi pala ankuese e ka paraqitur **me datë 09 Dhjetor 2016**, (e protok. me vulë pranimit në AKP, Property Office, Beograd me datë 16.12.2016). Kjo do të thotë se ankesa është paraqitur jashtë afatit të përcaktuar me ligj, 30 ditë, nga dita e pranimit të Vendimit të KKPK-së.
24. Gjykata ka gjetur se dorëzimi është bërë në përputhje me nenin 11.0.1, të Ligjit nr. 03/L-006, për Procedurën Kontestimore, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 38/2008), duke ju dorëzuar personalisht palës ankuese Vendimi i KKPK-së.
25. Pala ankuese në ankesën e paraqitur nuk ka cekur asnjë fakt dhe nuk ka paraqitur asnjë arsye për vonesën në paraqitjen e ankesës, ndërsa as gjykata në shkresat e lëndës nuk ka gjetur asnjë arsye të justifikueshme për vonesën u ushtrimit të kësaj ankese.
26. Prandaj, ankesa hedhet poshtë si e papranueshme në bazë të arsyeve procedurale të ligjit të lartpërmendur. Rrjedhimisht Gjykata Supreme nuk ka mundur t'i shqyrtoj arsyet e ankesës.
27. Edhe pse ankesa hedhet sepse është paraqitur pas afatit të lejuar ligjor, megjithatë Gjykata Supreme gjen se, Komisioni në vendimin e vet e ka bërë të qartë se nga provat e dorëzuara nga paraqitësi i ankesës të verifikuara edhe nga Sekretaria Ekzekutive e AKP-së, njoftimit nga vet ai dhe konfirmimit nga palët përgjegjëse, dëshkohet se pala ankuese, (palë kërkuese në AKP), ka paraqitur padinë me numër C.nr.239/05, me datë 28 shkurt 2005, kundër palëve përgjegjëse në Gjykatën Komunale në Prishtinë, për vërtetimin e të drejtës pronësore në pronën kontestuese.
28. Andaj me të drejtë dhe bazë ligjore vendimi i kundërshtuar i KKPK-së, mbështetet në nenin 18 të Rregullores së UNMIK nr.2006/50, e ndryshuar me Ligjit nr. 03/L-079, e cili nen përcakton

se; *“Dispozitat e kësaj Rregulloreje zbatohen për çdo kërkesë nga neni 3.1 i kësaj Rregulloreje që është parashtruar pranë gjykatës me kompetencë territoriale, **me kusht që procedura gjyqësore lidhur me kërkesën e tillë të mos ketë filluar para datës së hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje”**.* Rrjedhimisht, dispozita e nenit të cituar duhet të kuptohet se juridiksioni i AKP-së përjashtohet nëse pala apo palët kanë dorëzuar kërkesë-PADI, në gjykatën kompetente për konfirmimin e të drejtës pronësore, para datës 16 tetor 2006 ,(data e hyrjes në fuqi të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079). Prandaj me që procedimi gjyqësor në lidhje me pronën e kërkuar në gjykatë të rregullt nga pala ankuese kishte filluar në vitin 2005, kërkesa e tij në mungesë juridiksionit të AKP-së, është hedhë poshtë.

29. Në bazë të asaj që u tha më lart dhe në përputhje me nenin 13.3.(b) të Ligjit nr. 03/L-079 dhe nenin 195, paragrafin 1(a) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.
30. Ky aktgjykim nuk paragjykon të drejtë pronësore në pronën e kërkuar dhe nuk është me ndikim ndaj rezultatit përfundimtar të vendosjes lidhur me këtë pronë në gjykata të rregullta kompetente.

Këshillë ligjore:

Sipas nenit 13.6 të Ligjit 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË
GSK-KPA-A-002-2017, me datë 12 Maj 2020

Bashkp. Profesional,
Sherif Krasniqi

Kryetari i Kolegjit,
Ragip Namani